



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA HIMARE
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: BashkiaHimareSpile-Himare. Tel: 0393-2355. Fax: 0393-2355. E-mail: bashkiahimare@yahoo.com

Nr. 204 prot.

Himarë, më 04.07.2016

V E N D I M

Nr.60 . datë 30.06.2016

Mbi dhenjen e autorizimit Kryetarit te Bashkise Himare qe ne emer te Keshillit Bashkiak te zhvilloj te gjitha procedurat ligjore per konfliktet e kufinjve administrativo-territoriale te Bashkise Himare.

Baza ligjore : Ligji nr.139 /2015 dt.17.12.2014 “Per veteqeverisjen Vendore “neni 54

, pika h, neni 93 ,pika 1, neni 8/2 ,9/1.1-b., 9/1.2.9/9.6, 9/1.6-c, 64/b, nenit te 108/3 dhe 113 /2 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise , Ligjit Nr. 8653 datë 31.07.2000 “Për ndarjen administrativo- territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore”, VKM Nr.893 datë 11.06.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave pyje dhe kullota që do të transferohen në pronësi të qeverisjes vendore komuna Lukovë, të Qarkut Vlorë”,

Keshilli Bashkiak Himare ne mbledhjen e tij dt.30.06.2016 pasi mori ne shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkise Himare dhe shqetesimet te percollen Keshilltaret per konfliktin e kufinjve administrativo –territoriale te Bashkise Himare dhe vecanerisht ne ish Komunen Lukove me 14 pro dhe asnje kunder :

V E N D O S I

Mbi dhenjen e autorizimit Kryetarit te Bashkise Himare qe ne emer te Keshillit Bashkiak te zhvilloj te gjitha procedurat ligjore per konfliktet e kufinjve administrativo- territoriale te Bashkise Himare.

a/nga ana e Bashkise Himare te behet verifikimi i te gjithe territoreve te Nj.Q.V.lidhur me cenimin e tyre nga Njesite kufitare dhe te pregatitet matriali per proceset gjyqesore.

b/te filloje procedura gjyqesore ndaj Bashkise Delvine me objekt –shpalljen si te paligjshme te draft marreveshjes paraprake per percaktimin e kufinjve administrativme nr.254 prot. Dt.27.02.2012 i neneshkruar prej ish Kryetareve te Komunave Lukove dhe

Vergo duke i kërkuar gjykatës kompetente edhe lirimin e territoreve kullosore të fshatit Borsh, për të cilat bën fjalë akt marrëveshja.

c. ngarkohet Kryetari i Bashkisë Himarë të ngrëjë grupin e punës, ne baze te nenit 64 pika B ,te Ligjit nr.139/2015 dt.17.12.2015 “Per Veteqeverisjen Vendore “ duke autorizuar personat kompetentë, lidhur me ngritjen e padive apo mjeteve të tjera ligjore, deri në zgjidhjen përfundimtare të këtij konflikti.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut Vlorë

SEKRETARI

Theodhori BEJA



KRYETARI

Foto KARAVELLA

